



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
INSTITUTI I STATISTIKAVE
DREJTORIA E STATISTIKAVE SOCIALE

Nr. 115/21 Prot.

Tiranë, më 31 / 8 / 2021

Lënda: Kthim përgjigje

Z. DORIAN MATLIJA
DREJTOR EKZEKUTIV
QENDRËS "RES PUBLICA"
Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.24 , H.3, Ap.7, Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj me Nr. 115/21Prot., datë 31.08.2021, me lëndë "Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit", lidhur me pyetjen *Në kuadër të Censit 2022, a do jetë i mundur plotësimi online i anketës, duke marrë parasysh dhe vazhdimin e pandemisë shkaktuar nga COVID-19?*, ju informojmë se mbledhja e të dhënave për Censin e Popullsisë dhe Banesave do të realizohet përmes intervistave ballë për ballë me pyetësorë elektronik, duke përdorur tabletë.

Plotësimi online i pyetësorit nuk do të mundësohet, për shkak të kompleksitetit që e karakterizon këtë metodë dhe mungesës së eksperiencave të mëparshme në përdorimin e metodave të kombinuara për mbledhjen e të dhënave pranë familjeve.

Metoda e zgjedhur nga INSTAT për mbledhjen e të dhënave në Cens, garanton sigurimin e mbulimit të të gjithë popullsisë banuese në territorin e Republikës së Shqipërisë si një nga elementët kryesorë për vlerësimin e cilësisë së këtij procesi.

INSTAT do të marrë të gjitha masat që gjatë procesit të intervistimit të zbatohen masat anti-COVID në fuqi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ELSA DHULI

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Villazon Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al